



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2017 – Numri: 123

Tiranë – E premte, 26 maj 2017

PËRMBAJTJA

	Faqe
Udhëzim i ministrit të Financave nr. 15, datë 18.5.2017	Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 6, datë 30.1.2015, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar..... 6377
Urdhër i përbashkët i ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës dhe ministrit të Financave nr. 6132/1, datë 16.5. 2017	Për ndryshimin e urdhrit të përbashkët nr. 3069 datë 14.6.2016 për caktimin e tarifave të shërbimeve portuale në portet detare Vlorë, Sarandë dhe Shëngjin..... 6379
Urdhër i ministrit të Mjedisit nr. 154, datë 19.5.2017	Për delegim kompetence..... 6379
Urdhër i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave nr. 809, datë 25.5.2017	Për përcaktimin e kategorisë së zyrtarëve të administratës tatimore, të cilët i nënshtrohen kufizimeve të nenit 32, të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar..... 6379
Kërkesë e Ministrisë së Punëve të Brendshme nr. 1343/6, datë 22.5.2017	Për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Zgjerimi dhe rivitalizimi i parkut “Aqif Pasha””, në bashkinë e Elbasanit..... 6381
Kërkesë e Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës nr. 2987, datë 22.5.2017	Për shpronësim për interes publik, të pasurive pronë private që preken nga projekti “Përmirësimi i sistemit të kanalizimeve të Tiranës së madhe”, për pasuritë e llojit “arë” 6382
Kërkesë e Ministrisë së Zhvillimit Urban nr. 3069, datë 19.5.2017	Për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Ndërtim rruge në trekëndëshin e hyrjes së rrugës së palmave, pranë stacionit elektrik” 6383



UDHËZIM

Nr. 15, datë 18.5.2017

**PËR DISA NDRYSHIME NË
UDHËZIMIN NR. 6, DATË 30.1.2015 “PËR
TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR NË
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në zbatim të nenit 159, paragrafi 2 të ligjit nr. 92/2014, datë 24.7.2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, Ministri i Financave

UDHËZON:

Në udhëzimin nr. 6, datë 30.1.2015 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në nenin 19 “Transaksionet e ndërmjetësve”, pas pikës 4.1 shtohet pika 4.1/1 me këtë përmbajtje:

“4.1/1. Operatorët kryesorë të telekomunikacionit mund të zgjedhin të aplikojnë furnizimin e kartave të parapaguara ose kohës bisedore nëpërmjet kodeve tarifore ose paketave të parapaguara, me anë të distributorëve /furnizuesve të ndërmjetëm, duke zbritur direkt në faturë vlerën e ndërhyrjes në treg për të gjithë distributorët/furnizuesit e ndërmjetëm.

Operatori kryesor që zgjedh të aplikojë furnizimin e kartave të parapaguara ose kohës bisedore nëpërmjet kodeve tarifore ose paketave të parapaguara, duke zbritur direkt në faturë vlerën e ndërhyrjes në treg të hallkave pasardhëse, duhet paraprakisht të depozitojë në drejtorinë rajonale tatimore përkatëse një deklaratë me shkrim, sipas së cilës të shprehet zgjedhja e dëshiruar. Kjo deklaratë duhet të përmbajë veç të tjerash, listën e distributorëve/furnizuesve të ndërmjetëm.

Në rast se operatori kryesor zgjedh të aplikojë zbritjen direkt në faturë, për vlerën e ndërhyrjes në treg, duhet ta bëjë këtë për të gjithë distributorët/furnizuesit e tij të ndërmjetëm dhe për një periudhë jo më pak se 12 muaj të njëpasnjëshëm. Gjithashtu, nëse operatori kryesor heq dorë nga zgjedhja me qëllim që të aplikojë furnizimin e kartave të parapaguara ose kohës bisedore nëpërmjet kodeve tarifore ose

paketave të parapaguara, siç parashikohet në pikën 4.1 më lart, atëherë ai duhet të njoftojë paraprakisht organin tatimor.

Edhe në këtë rast operatorët kryesorë llogarisin dhe paguajnë TVSH për vlerën e plotë të kartave të parapaguara, ose të kodeve tarifore/paketave tarifore të telekomunikacionit, që ata u furnizojnë distributorëve/ndërmjetësve të tyre. Operatori kryesor zbrit direkt në faturë vlerën e ndërhyrjes në treg për të gjithë furnizuesit e mëvonshëm pa ndikuar TVSH-në e llogaritur, si më lart.

Furnizimi i këtyre kartave, ose kohës bisedore nëpërmjet kodeve tarifore ose paketave nga distributorët/furnizuesit e ndërmjetëm në furnizimet e mëtejshme nuk është objekt i aplikimit të TVSH-së, pasi TVSH është aplikuar për çmimin përfundimtar nga operatori kryesor që furnizon shërbimin e telekomunikacionit, por në çdo rast furnizimi tek furnizuesit e ndërmjetëm bëhet duke zbritur direkt në faturë vlerën e ndërhyrjes në treg, pa llogaritur TVSH. Distributorët/furnizuesit e ndërmjetëm nuk kanë të drejtë të zbrasin vlerën e TVSH-së së faturuar nga operatorët kryesorë për furnizimin e kryer, përse ata nuk kanë të drejtë të aplikojnë TVSH për furnizimet e mëtejshme të kryera në fazat pasardhëse.

Për qëllime dokumentimi të çdo transaksioni që kryejnë në fazat pasardhëse për shitjen e kartave/kodeve tarifore/paketave tarifore të telekomunikacionit, distributorët/furnizuesit e ndërmjetëm duhet të lëshojnë faturë tatimore pa llogaritur TVSH, në të cilën çmimi i këtij furnizimi është i barabartë me çmimin përfundimtar (përfshirë TVSH-në) për konsumatorin final, të faturuar prej operatorit kryesor në momentin e furnizimit të këtyre produkteve. Po kështu në çdo faturë të lëshuar në furnizimet e mëtejshme nga distributorët/furnizuesit e ndërmjetëm do të zbritet vlera e ndërhyrjes në treg të hallkave pasardhëse.

Shembull: Supozojmë që operatori kryesor i telekomunikacionit “X” hedh në treg karta telefonike me çmim me pakicë për konsumatorin final të barabartë me 1.000 lekë (përfshirë TVSH). Kjo shoqëri do të lëshojë një faturë ku TVSH e llogaritur do të jetë:

$833.4 + 166.6(TVSH) = 1.000$ lekë. TVSH-ja deklarohet dhe paguhet normalisht nga Operatori kryesor “X”. Po në këtë faturë Operatori kryesor i telekomunikacionit “X” zbrit vlerën e ndërhyrjes në treg të hallkave pasardhëse, p.sh.



150 lekë, pa ndikuar në TVSH-në e llogaritur si më sipër. Pra fatura e lëshuar nga Operatori kryesor "X" për distributorin/furnizuesin e ndërmjetëm "Y" do të paraqitet:

Përshkrimi i mallit ose shërbimit	Vlera pa t.v.sh.	t.v.sh.	Vlera me t.v.sh.
Kartë e parapaguar	833.4	166.6	1.000 lekë
Zbritje për ndërhyrjen në treg	(150)	-	(150)lekë
Totali	683.4	166.6	850 lekë

Shoqëria distributore/furnizuese e ndërmjetme "Y" që blen kartën me faturën e mësipërme, nuk llogarit më TVSH në rishitjen e kësaj karte dhe nuk ka të drejtë të zbrësë 166.6 lekë TVSH të faturës së lëshuar nga operatori kryesor.

Distributori/furnizuesi i ndërmjetëm i regjistron në librin e blerjes dhe në deklaratën e TVSH-së faturën e blerjes së kartave si "blerje pa TVSH" dhe faturën e shitjes së tyre si "shitje pa TVSH".

Qarkullimi i distributorit/furnizuesit të ndërmjetëm në përputhje me nenin 119 të ligjit llogaritet në bazë të çmimit gjithsej që duhet të paguajë blerësi (konsumator final) për shërbimet e mësipërme.

2. Në nenin 45 "Ushtrimi i së drejtës për të zgjedhur aplikimin e TVSH-së për furnizimet e përjashtuara", pas fjalisë së dytë me përmbajtjen "Kjo e drejtë është e kufizuar", shtohen fjalitë me këtë përmbajtje:

"Gjithashtu, pavarësisht nga trajtimi si furnizim i përjashtuar nga TVSH i furnizimit (shitjes) të ndërtesës ose i pjesëve të një ndërtese, i parashikuar në nenin 53, pika g) të ligjit, personi i tatueshëm që furnizon ndërtesën ose pjesë të një ndërtese, gëzon të drejtën e zgjedhjes për ta trajtuar këtë furnizim si furnizim të tatueshëm me TVSH 20%.

E drejta për të zgjedhur aplikimin e TVSH-së për furnizimin e ndërtesës ose i pjesëve të një ndërtese është e kufizuar dhe nuk mund të ushtrohet prej personave të tatueshëm që furnizojnë apartamente, ndërtesa apo ambiente për banim ose kur blerësi është një individ".

3. Në nenin 55 "Kufizime të zbritjes së TVSH-së për disa furnizime", pas fjalisë me përmbajtjen, "Me kushtin që gazoili i blerë të përdoret vetëm për nevoja të veprimtarisë ekonomike të tatueshme, e drejta për të zbritur TVSH-në.....sipas veprimtarive", shtohen fjalitë me përmbajtjen si më poshtë:

"Shpenzimet faktike për gazoilin për çdo veprimtari ekonomike duhet të justifikohen me volumin e punës së kryer, rrugët e realizuara nga mjeti/et, normativat e konsumit të gazoilit për rrugë ose proces të kryer, etj. Në çdo rast, këto shpenzime duhet të jenë të kryera realisht dhe të justifikuar sipas veprimeve të realizuara për nevoja të veprimtarisë ekonomike, të provuara me dokumentacionin përkatës, por jo më shumë se normativat e përcaktuara në këtë udhëzim".

4. Në nenin 64 "Procedura e rimbursimit dhe përjashtimit për diplomatët, organizatat ndërkombëtare, NATO", bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a. Në pikën 2, në fjalinë që fillon me togfjalëshin "Për blerjet brenda vendit" hiqet togfjalëshi me përmbajtjen:

"me kusht që çdo faturë blerjeje të jetë më e madhe se 10.000 lekë"

b. Pika e dytë e numërtuar "2" që fillon me fjalinë "Përsa u përket blerjeve që personeli i NATO-s dhe bazat e saj bëjnë brenda vendit...", numërohet pika "3"

5. Në nenin 66 "Faturimi" bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a. Në fund të pikës "4" shtohet fjalia me përmbajtjen:

"Personi i tatueshëm lejohet të përdorë fatura tatimore me numër serial unik dhe të papërsëritshëm, të printuara nga sistemi i tij i regjistrimeve, sipas kushteve dhe procedurës të përcaktuara për këtë qëllim në ligjin dhe udhëzimin "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë".

b. Pika "5", hiqet.

c. Pika "6" numërohet si pika "5".

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Arben Ahmetaj

**URDHËR I PËRBASHKËT**

Nr. 6132/1, datë 16.5.2017

**PËR NDRYSHIMIN E URDHËRIT TË
PËRBASHKËT NR. 3069 DATË 14.6.2016
PËR CAKTIMIN E TARIFAVE TË
SHËRBIMEVE PORTUALE NË PORTET
DETARE VLORË, SARANDË DHE
SHËNGJIN**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës, nenit 84 të ligjit nr. 9251, datë 8.7.2004 “Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, ligji nr. 7581, datë 7.7.1992 “Për çmimet dhe tarifat” i ndryshuar, Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës dhe Ministri i Financave

URDHËROJNË:

Ndryshimin e urdhrit të përbashkët nr. 3069 datë 14.6.2016 për “Caktimin e tarifave të shërbimeve portuale në portet detare Vlorë, Sarandë dhe Shëngjin” si më poshtë:

1. Në kapitullin 1, pika 1.1. “Përkufizime” tek pika 1 “Interpretim” të shtohet germa “e” me përmbajtje:

“e “Anije pasagjerësh” është anija që transporton më shumë se 12 pasagjerë.”

2. Në kapitullin 3, në pikën 3.4. poshtë titullit “Tarifa për shërbimin e heqjes së plehrave për çdo ditë është:” shtohen fjalët:

“Për anijet e mallrave”

3. Në kapitullin 3, pika 3.4. në paragrafin e parë pas gërmës “g” të hiqet fjala “RO-RO”.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE

Arben Ahmetaj

MINISTRI I TRANSPORTIT

DHE INFRASTRUKTURËS

Sokol Dervishaj

URDHËR

Nr. 154, datë 19.5.2017

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës, të shkronjës “d” të nenit 28 të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe

funksionimin e Këshillit të Ministrave” dhe të neneve 28, 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” si dhe të pikës 3 të nenit 15, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave administrative që zotëron Z. Alqi Bllako Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Drejtorit të Drejtorisë Juridike, Komunikimit dhe Prokurimeve Znj. Alba Thoma me përjashtim të detyrave të ngarkuara nga legjislacioni në fuqi për menaxhimin financiar.

2. Këto kompetenca do të ushtrohen nga znj. Alba Thoma Drejtor i Drejtorisë Juridike, Komunikimit dhe Prokurimeve nga data 23.5.2017 deri më datë 20.6.2017.

3. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet z. Alqi Bllako Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit dhe znj. Alba Thoma Drejtor i Drejtorisë Juridike, Komunikimit dhe Prokurimeve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I MJEDISIT

Lefter Koka

URDHËR

Nr. 809, datë 25.5.2017

**PËR PËRCAKTIMIN E KATEGORISË SË
ZYRTARËVE TË ADMINISTRATËS
TATIMORE, TË CILËT I
NËNSHTROHEN KUFIZIMEVE TË
NENIT 32, TË LIGJIT NR. 9367, DATË
7.4.2005 “PËR PARANDALIMIN E
KONFLIKTIT TË INTERESAVE NË
USHTRIMIN E FUNKSIONEVE
PUBLIKE”, TË NDRYSHUAR**

Në zbatim të nenit 42 pika 2 dhe nenit 32 germa “c”, të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar, urdhrit nr. 126, datë 2.8.2016, të Kryeministrit “Për miratimin e strukturës organizative dhe numrit të punonjësve të administratës tatimore qendrore”, urdhrit nr. 19, datë 22.2.2017, të Ministrit të Financave “Për miratimin e rregullores së brendshme “Për funksionimin e administratës tatimore qendrore”



dhe Rregullores së Brendshme të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave,

URDHËROJ:

Kategoria e zyrtarëve të administratës tatimore, që do të përfshihen në kufizimet e parashikuara në nenin 32 të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, i ndryshuar, të cilët nuk mund të zotërojnë në mënyrë aktive, asnjë aksion ose pjesë në kapital në shoqëritë tregtare, që shlyejnë detyrimet tatimore ose ushtrojnë veprimtari sipas fushës apo juridiksionit territorial, të kategorizuar sipas funksionit do të jenë:

- 1. Drejtori i Përgjithshëm**
- 2. Zëvendësdrejtorët e përgjithshëm**
- 3. Kabineti**
 - Drejtor Kabineti
 - Këshilltar
- 4. Drejtoria e Investigimit të Brendshëm (DIBA)**
 - Drejtor drejtorie
 - Inspektorët
- 5. Drejtoria e Auditit të Brendshëm**
 - Drejtor drejtorie
 - Inspektorët
- 6. Drejtoria e Hetimit Tatimor**
 - Drejtor drejtorie
- 7. Sektori i Hetimit Tatimor**
 - Përgjegjës sektori
 - Inspektorët
- 8. Sektori i Analizës**
 - Përgjegjës sektori
 - Inspektorët
- 9. Sektori i Zbatimit (Task Forcë)**
 - Përgjegjës sektori/zyre
 - Inspektorët
- 10. Sektori Parandalimit të Pastrimit të Parave**
 - Përgjegjës sektori
 - Inspektorët
- 11. Drejtoria e Menaxhimit të Riskut**
 - Drejtor drejtorie
- 12. Sektori i Përmbushjes**
 - Përgjegjës sektori
 - Inspektorët
- 13. Sektori i Analizës së Riskut**
 - Përgjegjës sektori
 - Inspektorët

- 14. Drejtoria e Shërbimit të Tatimpaguesve**
 - Drejtor drejtorie
 - Përgjegjës sektori
- 15. Drejtoria e Mbledhjes me Forcë**
 - Drejtor drejtorie
- 16. Sektori i Monitorimit të Marrëveshjeve**
 - Inspektorët
- 17. Sektori i Menaxhimit dhe Analizës së Detyrimeve të Papaguara**
 - Përgjegjës sektori
 - Inspektorët
- 18. Drejtoria e Analizës dhe Kontabilitetit**
 - Drejtor drejtorie
 - Përgjegjës sektori
- 19. Drejtoria e Kontrollit Tatimor**
 - Drejtor drejtorie
 - Sektori i Transferimit të Çmimit
- 20. Përgjegjës Sektori**
 - Inspektorët
- 21. Sektori i Kontrollit Tatimor**
 - Përgjegjës sektori
 - Inspektorët
- 22. Sektori i Cilësisë dhe Standardizimit të Procedurave**
 - Përgjegjës Sektori
 - Inspektorët
- 23. Drejtoria Rimbursimit të TVSH-së**
 - Drejtor drejtorie
 - Inspektorët
- 24. Drejtoria Ligjore dhe Teknike**
 - Drejtor drejtorie
 - Përgjegjës sektori
- 25. Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit**
 - Drejtor drejtorie
 - Përgjegjës sektori
- 26. Drejtoria e Menaxhimit të Projekteve**
 - Drejtor drejtorie
 - Inspektorët
- 27. Drejtoria e Administratës dhe Prokurimeve**
 - Drejtor drejtorie
 - Përgjegjës sektori
- 28. Drejtoria e Burimeve Njerëzore**
 - Drejtor drejtorie
 - Përgjegjës sektori
- 29. Qendra e Pagesave**
 - Drejtor Qendre
- 30. Qendra e Thirrjeve**
 - Drejtor Qendre
 - Përgjegjës sektori

**KËRKESË**

Nr. 2987, datë 22.5.2017

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës shpall kërkesën “Për shpronësimet për interes publik, të pasurive pronë private që preken nga projekti “Përmirësimi i sistemit të kanalizimeve të Tiranës së Madhe”, për pasuritë e llojit “arë””.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Agjencia Kombëtare e Ujësjetës Kanalizimeve. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur, në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000 të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe përllogaritjes së masës së shpërblimit për pasuritë pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik” i ndryshuar, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i

këtij afati për publikun, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë, apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës).

Ky publikim bëhet për pasurinë e llojit “arë”. Pronarët do të kompensohen, për efekt shpronësimi, pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë pranë Agjencisë Kombëtare të Ujësjetës Kanalizimeve (subjekti kërkues në bazë të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private për interes publik”.

Vlera totale e shpronësimit është 26 588 800 (njëzet e gjashtë milion e pesëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e tetëqind) lekë.

ZËVENDËSMINISTRI I TRANSPORTIT
DHE INFRASTRUKTURËS
Bahri Shaqiri

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS
AGJENCIA KOMBËTARE E UJËSJELLËS KANALIZIME
SEKTORI I SHPRONËSIMEVE

Lista e pronarëve që preken nga projekti "Përmirësimi i Sistemit të Kanalizimeve të Tiranës së Madhe"

Nr.	Pronari			zona kad	Nr. pas	Lloji pas	Sip. Totale (m ²)	Vlerësimet			Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri					Sip Shpronësimit (m ²)	Çmimi (lekë/m ²)	Vlera (lekë)	
1	BP. Hatixhe Balla, Ibrahim Balla, Islam Balla, Metie Balla, Sulejman Balla, Zenepe Balla,			3866	193/29	Arë	11000	11000	448	4928000	Konfirmuar nga ZVRPP
2	Asllan	Sule	Shima	3866	123/11/1	Arë	6250	6250	448	2800000	Konfirmuar nga ZVRPP
3	Hysen	Ymer	Basha	3866	193/1	Arë	3200	2470	448	1106560	Konfirmuar nga ZVRPP
4	Hamit	Bajram	Koçi	3866	193/27	Arë	4630	4630	448	2074240	Konfirmuar nga ZVRPP
5	Bashkim	Limani	Hoxha	3866	202/2	Arë	5000	4300	448	1926400	Konfirmuar nga ZVRPP
6	Ali	Jaho	Shehu	3866	181/16	Arë	3600	3000	448	1344000	Konfirmuar nga ZVRPP
7	Gëzim	Hyqmet	Shehu	3866	181/15	Arë	3600	2300	448	1030400	Konfirmuar nga ZVRPP
8	BP Genci Arif Koçi, Zamir Arif Koçi			3866	193/26	Arë	10000	10000	448	4480000	Konfirmuar nga ZVRPP
9	Ramazan	Xhemal	Hoxha	3866	202/2/1	Arë	5000	4400	448	1971200	Konfirmuar nga ZVRPP
10	Lavdërim		Tota	3866	181/27	Arë	3700	3000	448	1344000	Konfirmuar nga ZVRPP
11	Kadri	Osman	Hasmuça	3866	181/20	Arë	4800	4800	448	2150400	Konfirmuar nga ZVRPP
12	Haxhi	Sabri	Hasmuça	3866	181/19	Arë	3200	3200	448	1433600	Konfirmuar nga ZVRPP
Shuma								59350		26588800	

**KËRKESË****Nr. 3069, datë 19.5.2017****PËR SHPRONËSIM PUBLIK**

Ministria e Zhvillimit Urban shpall kërkesën për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Ndërtim rruge në trekëndëshin e hyrjes së rrugës së palmave, pranë stacionit elektrik”.

Subjekti kërkues i këtij objekti është bashkia Lushnjë.

Me anë të këtij publikimi kërkohet të vëmë në dijeni personat, të cilët preken nga ky shpronësim

që konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të vendimit nr. 89, datë 3.2.2016 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Vlera totale e shpronësimit është 4 295 234 (katër milion e dyqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e dyqind e tridhjetë e katër) lekë.

ZËVENDËSMINISTRI I ZHVILIMIT
URBAN
Alfred Dalipi

Vlera e shpronësimit e trullit të znj. Lula Ali Duma+bashkëpronare në lagjen “Loni Dhamo”,
Zona kadastrale 8572

Investitori: Bashkia Lushnjë

Nr.	Nr. i pasurisë	Emri, mbiemri	Zona kadastrale	Lloji i pronës	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlera	Konfirmimi nga ZVRPP-ja
1	1/526	Lula Ali Duma+bashkëpronare	8572	truall	m ²	479.7	8954	4295234	Shkresa nr.1623/2, datë 21..3.2017
						Shuma totale		4295234	

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2017

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”

Çmimi 84 lekë